

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 15 mars 2012

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 15 mars 2012

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E PROKURORISË PËR LEJE PËR APELIN E
VENDIMIT MBI MOCIONIN E PROKURORISË PËR PRANIMIN E PROVAVE NË
SALLËN E GJYQIT, NDRYSHIMIN E LISTËSË SË DËSHMITARËVE DHE PROVAVE
MATERIALE TË RREGULLËS 65TER DHE PRANIMIN E PROVAVE SIPAS
RREGULLËS 92TER**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE (“Dhoma”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”) ka marrë “Mocion i Prokurorisë për leje për apelimin e Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92ter” paraqitur publikisht nga Zyra e Prokurorisë (“Prokuroria”) më 2 shkurt 2012 (“Mocioni i Prokurorisë”) dhe nxjerr vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIA PROCEDURALE

1. Më 5 tetor 2011, Prokuroria paraqiti publikisht “Mocion i Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92ter” bashkë me Shtojcat publike A dhe B, ku, midis të tjerash, kërkoi pranimin si provë të pjesëve të librit me titull *Rrëfim për Luftën dhe Lirinë (Dialog me komandantin Ramush Haradinaj* (“Libri”) (dokument i Rregullës 65ter numër 3002), leje për përfshirjen e Marlène Schnieper-it në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë të Rregullës 65ter dhe për thirrjen e saj si dëshmitare sipas Rregullës 92ter të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”) dhe leje për përfshirje të një kopjeje të Librit të nënshkruar nga Ramush Haradinaj dhe të letrës së Mbrojtjes së Haradinajt të datës 9 janar 2007 (“Letra”) (dokumente të Rregullës 65ter me numër 3112 dhe 3113) në Listën e Rregullës 65 ter të provave materiale të Prokurorisë.

2. Më 26 janar 2012, në vendimin e saj (“Vendimi i Apeluar”)¹, Dhoma me shumicën, me përjashtim të mendimit mospajtues të gjykatësit Delvoie, rrëzoi kërkesat e

¹ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92ter, 26 janar 2012.

Prokurorisë. Më 3 shkurt 2012, gjykatësi Delvoie paraqiti mendimin pjesërisht mospajtues të tij.²

3. Më 2 shkurt 2012, Prokuroria paraqiti Mocionin në fjalë. Më 16 shkurt 2012, Haradinaj paraqiti “Përgjigje e Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për leje për apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92ter” (“Përgjigje e Haradinajt”). Më 22 shkurt 2012, Prokuroria paraqiti “Kërkesë për Leje për Kundërpërgjigje dhe Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Ramush Haradinajt ndaj Mocionit të Prokurorisë për leje për apelim” (“Kundërpërgjigje e Prokurorisë”).

II. PARASHTRIME

4. Prokuroria kërkon leje prej Dhomës për apelim të ndërkohshëm të Vendimit të Shumicës për mospranimin si provë të pjesëve të Librit, si dhe të vendimeve për refuzimin e kërkesës për përfshirjen e Marlène Schnieper-it në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë të Rregullës 65ter dhe për thirrjen e saj si dëshmitare sipas Rregullës 92ter (A), lejes për përfshirjen e kopjes së Librit që Haradinaj e nënshkroi me dedikim për Schnieper-in dhe të Letrës së Mbrojtjes së Haradinajt ku Haradinaj bën të ditur se nuk e kundërshton autenticitetin dhe pranueshmërinë e tërë Librit si provë.³

5. Prokuroria parashtroi se Vendimi i Apeluar ka lidhje me prova me gjasë të rëndësishme për Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore. Parashtrohet se rrëfimi i paraqitur në Libër është i besueshëm për arsye se në një letër drejtuar Prokurorisë, avokati i Haradinajt bëri të ditur se nuk kundërshtohet autenticiteti dhe pranueshmëria e tërë Librit si provë dhe se nuk ka nevojë për fakte të pranuar nga Palët bazuar në librin. Prokuroria argumenton se për shkak të rëndësisë së pikave të kundërshtuara nga Palët në këtë proces,

² Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Mendimi pjesërisht mospajtues i gjykatësit Delvoie në lidhje me Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92ter, 3 shkurt 2012.

³ Mocioni i Prokurorisë, para. 1-2.

mospranimi i pjesëve të paraqitura të Librit ndikon thelbësisht në kryerjen e gjyimit të drejtë dhe në rezultatin e gjyimit.⁴ Në mbështetje të këtij argumenti, Prokuroria i referohet përmbajtjes së Librit e cila sipas Prokurorisë është e rëndësishme për disa pika të kundërshtuara nga Palët.⁵

6. Në lidhje me kushtin e dytë për miratimin e lejes për apelim të ndërkohshëm, Prokuroria parashtro se mosmiratimi i lejes për apelim të ndërkohshëm të Vendimit mund të ketë për pasojë apelim të mëvonshëm të panevojshëm dhe se për këtë arsye, moszgjidhja e kësaj çështjeje në këtë fazë mund të ndikojë thelbësisht në rezultatin e procesit.⁶ Prokuroria argumenton se “rëndësia e kësaj prove” mund të rezultojë në nevojën për rishikimin e të gjitha provave që kanë lidhje me këtë çështje gjë që mund të ndërlikojë dhe vonojë edhe më shumë vendimin përfundimtar mbi Aktakuzën e Rishikuar.

7. Haradinaj parashtro se Mocioni i Prokurorisë duhet të rrëzohet për arsye se Prokuroria nuk ka përmbushur kushtet e Rregullës 73(B), se arsyetimi i Dhomës nuk është i gabuar dhe se Dhoma ka zbatuar standardin e duhur ligjor për pranimin e provave.⁷ Sipas Haradinajt, Prokuroria nuk ka përmbushur kushtin e parë të miratimit të lejes për apelim të ndërkohshëm për arsye se në Mocionin e saj thjeshtë ka përsëritur të njëjtat argumente si ato në kërkesën e saj për pranimin e pjesëve të librit, ku shpjegoi gjerë e gjatë pse pranimi i pjesëve të librit ishte i rëndësishëm për çështjen e saj.⁸ Haradinaj më tej parashtro se Prokuroria nuk ka paraqitur asnjë aspekt të veçantë që ndikon thelbësisht në procesin gjyqësor apo në rezultatin e gjyimit, por vetëm shtjellon mospajtimin e saj në lidhje me përfundimin e Shumicës.⁹ Në lidhje me kushtin e dytë të miratimit të lejes për apelim të ndërkohshëm, Haradinaj parashtro se sugjerimi se miratimi i kërkesës së Prokurorisë do ta ndihmonte thelbësisht procesin është i pabazë. Argumentohet se përkundrazi, një apelim i ndërkohshëm në këtë fazë do ta stërzgjaste pa

⁴ Mocioni i Prokurorisë, para. 4.

⁵ Mocioni i Prokurorisë, para. 5-7.

⁶ Mocioni i Prokurorisë, para. 8.

⁷ Përgjigje e Haradinajt, para. 3.

⁸ Përgjigje e Haradinajt, para. 10.

⁹ Përgjigje e Haradinajt, para. 11.

arsye procesin.¹⁰ Sipas Haradinajt Prokuroria gabon kur argumenton se procesi do të ndërlikohej edhe më shumë nëqoftëse do të shpallej pafajësi për shkak të mospranimit të kësaj prove. Ai argumenton se në jurisprudencën e TPNJ-së nuk ekziston një arsyetim i tillë dhe Vendimi i Apeluar nuk e ndalon Prokurorinë që “të përpiqet ta bindë Dhomën e Apelit se sikur prova të ishte pranuar, duke marrë parasysh tërësinë e provave në këtë çështje do të shpallej fajësi”.¹¹

8. Në kundërpërgjigjen e saj, Prokuroria parashtroi se Haradinaj gabon kur argumenton se Prokuroria duhet të identifikojë gabimin nëqoftëse do t’i miratohet leja për apelim të ndërkohshëm. Në mbështetje të këtij argumenti, Prokuroria parashtroi se Dhoma e ka bërë të qartë mendimin e saj se “korrektësia e vendimit nuk është faktor i rëndësishëm në miratimin apo mosmiratimin e apelimit të ndërkohshëm”. Prokuroria gjithashtu parashtroi se në Përgjigjen e tij, Haradinaj gabon kur sugjeron se Prokuroria nuk mund të mbështetet në argumente që lidhen me rëndësinë e Librit për arsye se rëndësia e Librit është thelbësore për Dhomën në marrjen e vendimit të saj në lidhje me përmbushjen e kushtit të Rregullës 73(B).¹²

III. LIGJI PËRKATËS

9. Sipas Rregullës 73(B), Dhoma Gjyqësore mund të miratojë leje për apelim të ndërkohshëm “nëqoftëse vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte në mënyrë të dukshme kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose rezultatin e gjykimit dhe për të cilën, sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, një vendim i menjëhershëm nga ana e Dhomës së Apelit mund ta ndihmojë thelbësisht procesin”. Rregulla 73(b) kushtëzon miratimin e lejes për apelim të ndërkohshëm me përmbushjen e dy kushteve të parashtruara në këtë Rregull, por edhe nëqoftëse dy kushtet janë përmbushur, Dhoma ka

¹⁰ Përgjigje e Haradinajt, para. 14.

¹¹ Përgjigje e Haradinajt, para. 13, citon *Prokurori k. Karaxhiqit*, Lënda Nr. IT-95-5/18-1, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për rishikim ose ndryshe leje për apelim të Vendimit në lidhje me dëshminë e Miroslav Deronjikut, 20 prill 2010, para. 15.

¹² Kundërpërgjigje e Prokurorisë, 22 shkurt 2012, para. 2.

kompetencë të miratojë ose të mos miratojë një leje të tillë.¹³ Kërkesa për leje për apelim të ndërkohshëm nuk ka të bëjë me arsyetimin e drejtë apo të gabuar të një vendimi meqenëse kjo i takon apelit, qoftë të ndërkohshëm apo pas nxjerrjes së aktgjykimit,¹⁴ e as mundësi për palën që ta informojë Dhomën Gjyqësore se e kundërshton vendimin e Dhomës.¹⁵

IV. DISKUTIM

10. Dhoma shqyrtoi parashtrimet e Palëve, Në lidhje me kushtin e parë për miratimin e lejes për apelim të ndërkohshëm, Prokuroria parashtron se për shkak të rëndësisë së pikave të kundërshtuara nga Palët, mospranimi i pjesëve të paraqitura të Librit ndikon thelbësisht në kryerjen e gjykimit të drejtë dhe në rezultatin e gjykimit.

11. Dhoma konkludon se Prokuroria nuk shpjegoi si dhe pse mospranimi i provës ndikon thelbësisht në kryerjen e gjykimit të drejtë dhe të shpejtë dhe në rezultatin e gjykimit.¹⁶ Ndonëse në Mocionin e saj Prokuroria argumenton rëndësinë e provës, ajo thjesht përsërit argumentet e paraqitura në mocionin e parë në lidhje me autenticitetin,

¹³ *Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për rishikim të Vendimit të Shumicës për mospranimin e dokumentit të Rregullës 65ter numër 03003, ose ndryshe për leje për apelim të ndërkohshëm të Vendimit të Shumicës me mendimin pjesërisht mospajtues të gjykatësit Delvoie, 27 shkurt 2012, para. 13; *shih* gjithashtu *Prokurori k. Strugarit*, Lënda Nr. IT-01-42-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për leje për apelim të ndërkohshëm, 17 qershor 2004, para. 2; *Prokurori k. Miqo Stanishiqit dhe Stojan Zhuplaninit*, Lënda Nr. IT-08-91-PT, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për leje për apelim të ndërkohshëm ("Vendim"), 22 prill 2009, para. 11.

¹⁴ Vendimi *Stanishiq dhe Zhuplanin*, para. 11; *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për leje për apelim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi Mocionin e Prokurorisë për Procedurë *Voir Dire*, ("Vendim i 20 qershorit 2005"), 20 qershor 2005, para. 4; *Prokurori k. Çermakut dhe Markaçit*; *Prokurori k. Ante Gotovinës*, Lëndët Nr. IT-03-73-PT, IT-01-45-PT, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për leje për apelim të Vendimit mbi Mocionin Përmbledhës të Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës dhe për Bashkim të Aktakuzave, 14 gusht 2006, para. 10; *Prokurori k. Millan Millutinoviqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për leje për apelim të ndërkohshëm të Vendimit të Rregullës 98bis, ("Vendim") 14 qershor 2007, para. 4.

¹⁵ *Prokurori k. Millosheviqit*, Vendim i 20 qershorit 2005, para. 3; *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për leje për apelim të vendimit në lidhje me dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes Barry Litnchy, 18 maj 2005, f. 5; *Çështja k. Florence Hartmann*, Lënda Nr. IT-02-54-R77.5, Vendim mbi Mocionin për leje për apelim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore në lidhje me pezullimin e procesit për shkak të shpërdorimit të procesit, 13 maj 2009, para. 3.

¹⁶ *Prokurori k. Stanishiqit dhe Zhuplaninit*, Lënda Nr. IT-08-91-T, Vendim për mosmiratimin e Mocionit të Prokurorisë për leje për apelim të Vendimit të datës 14 prill 2000 (Ndryshim i Listës së Provave), 18 qershor 2010, para. 3.

vlerën provuese dhe besueshmërinë e provës së paraqitur.¹⁷ Prokuroria parashtroi se rrëfimi i paraqitur në Libër është i besueshëm për arsye se në Letrën drejtuar Prokurorisë, Mbrojtja e Haradinajt bëri të ditur se nuk e kundërshton autenticitetin dhe pranueshmërinë e Librit si provë. Dhoma e hodhi poshtë këtë argument. Letra mbi të cilën mbështetet Prokuroria ishte pjesë e komunikimit të privilegjuar midis Palëve para fillimit të procesit të parë gjyqësor. Haradinaj kundërshton pranimin e Librit në këtë proces. Dhoma thekson se kërkesa për leje për apelim nuk është mundësi për një palë që ta informojë Dhomën Gjyqësore se e kundërshton vendimin e saj.¹⁸ Dhoma nuk është bindur se Prokuroria vërtetoi se mospranimi i këtij materiali do të ndikonte thelbësisht në kryerjen e gjykimit të drejtë dhe të shpejtë dhe në rezultatin e gjykimit. Kushti i parë për miratim të lejes për apelim nuk është përmbushur.

12. Duke marrë parasysh konkluzionin e mësipërm, nuk është e nevojshme që Dhoma të shqyrtojë kushtet e tjera që parashtroi Rregulla 73(B).

V. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura dhe bazuar në Rregullat 73(B), 89(C) dhe 126bis të Rregullores, Dhoma:

- a. **MIRATON** kërkesën e Prokurorisë për leje për kundërpërgjigje dhe mban shënim Kundërpërgjigjen, dhe
- b. **RRËZON** tërësisht Mocionin e Prokurorisë.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

¹⁷ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda Nr. IT-04-84bis-T, Mocion i Prokurorisë për pranimin e provave në sallën e gjyqit, ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65ter dhe pranimin e provave sipas Rregullës 92ter, 5 tetor 2011, para. 6-7. Mocioni i Prokurorisë, para. 4-7.

¹⁸ Shih më lart para. 9.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 15 mars 2012.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]